



**USAID**  
NGA POPULLI AMERIKAN

**PROGRAMI I QEVERISJES  
VENDORE NË SHQIPËRI**

## **Programi i Qeverisjes Vendore në Shqipëri**

Programi i Qeverisjes Vendore në Shqipëri (LGPA) i Agjencisë për Zhvillim Ndërkombëtar të Shteteve të Bashkuara (USAID) punon me dhjetë bashki në të gjithë Shqipërinë me qëllim që të mbështesë zhvillimin e ekonomisë vendore, të përmirësojë qeverisjen dhe të forcojë pjesëmarrjen e shoqërisë civile dhe sektorit privat në zhvillimin vendor. Bashkitë partnere të LGPA të cilat tregohen në hartën prapa janë Fier, Fushë Krujë, Gramsh, Himarë, Korçë, Kukës, Lezhë, Librazhd, Pogradec, and Shkodër.

### **Zhvillimi i Ekonomisë Vendore**

LGPA do të nxisë dhe lehtësojë zhvillimin e ekonomisë vendore në bashkitë e synuara (përzgjedhura) në mënyrë që të rrisë investimet, të krijojë mundësi për punësim, të rrisë të ardhurat dhe së fundmi të rrisë bazën e tatimeve dhe taksave. Në secilën bashki të synuara do të krijohet një Komitet Bashkiak për Zhvillimin Ekonomik me përfaqësim të gjerë dhe bipartizan, duke përfshirë edhe përfaqësues të sektorit publik, privat dhe shoqërisë civile. Komitetet Bashkiake për Zhvillimin Ekonomik do të krijojnë një vizion strategjik për zhvillimin e ardhshëm ekonomik të bashkisë dhe do të vendosin prioritete mbi veprimet e menjëhershme në përputhje me planin afatshkurter të zhvillimit ekonomik vendor. Komiteti do të identifikojë mundësitë ekzistuese për përmirësimin e shërbimeve publike të cilat do të çojnë në thithjen e investimeve. LGPA do të punojë me Komitetet Bashkiake për Zhvillimin Ekonomik për të promovuar bashkinë dhe për të identifikuar dhe tërhequr investitorë të mundshëm.

### **Qeverisje Vendore**

LGPA do të sigurojë mbështetje teknike dhe trajnim për stafin në dhjetë bashkitë e synuara në shumë çështje përfshirë mbledhjen e taksave, menaxhimin e aseteve, buxhetimin, huamarrjen, shpërndarjen e shërbimeve. Ky komponent njëherazi kontribuon dhe gjithashtu çon më tej përpjekjet e ndërmarra në komponentin e Zhvillimit të Ekonomisë Vendore. Bashkitë do të identifikojnë asetet që mund të jepen me qera dhe ato që mund të vihen në dispozicion të investitorëve private për t'u përmirësuar si rrjedhojë e një menaxhimi më të mire të tyre. Zhvillimi ekonomik si dhe përmirësimi i sistemit të mbledhjes së taksave do t'i japë mundësi bashkive të rrisin të ardhurat nga mbledhja e tyre. Rritja e të ardhurave nga një menaxhim më i mire i aseteve si dhe mbledhja e tatimeve dhe taksave do t'u mundësojë bashkive të synuara të përmirësojnë cilësinë dhe eficiencën e shërbimeve të ofruara qytetarëve dhe bizneseve.

### **Pjesëmarrja e Shoqërisë Civile dhe Sektorit Privat**

Bashkitë e synuara do të forcojnë përfshirjen e grupeve të shoqërisë civile, grupeve të vecanta të interesit dhe komunitetin e biznesit në procesin e qeverisjes vendore. Kjo do të arrihet duke përfshirë shoqërinë civile dhe sektorin privat në Komitetet Bashkiake për Zhvillimin Ekonomik, duke ngritur mekanizmat e buxhetimit me pjesëmarrje, duke krijuar mjete të komunikimit të qeverisjes vendore sic janë gazetat dhe faqet e internetit. Transparenca e bashkive të synuara do të rritet si rezultat i takimeve të hapura të këshillit bashkiak, proceseve të hapura për blerjet, dhënitë me qera dhe vënien në dispozicion të aseteve të bashkisë si dhe një procesi të hapur në trajtimin e çështjeve të buxhetit.

### ***Përmirësimi i Qeverisjes Vendore Npërmjet Zhvillimit Ekonomik***